



Drejtoria për Shërbime Publike  
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge  
Department of Municipal Public Services

Datë/Datum/Date:	06.07.2023
Referenc-ë	
Për/Za/To:	z.Defrim Kafexhiu, Kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit
CC:	Anëtarët e kuvendit komunal të Rahovecit
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë

### Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit vepron sipas planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike.

Komuna ka sipërfaqe prej 275,5 km<sup>2</sup>, me 35 vendbanime dhe një qendër urbane.

Zonat e përfshirjes së HHP-ve në këtë dokument përfshin;

1. Mirëmbajtjen e gjelbërimit, të ulët, të mesëm dhe të lartë,
2. Mirëmbajtjen e ambienteve të ndënuara, sheshe, shtigje për këmbësorë dhe sipërfaqe të shtruara,
3. Mirëmbajtjen e hapësirave për parkim automjeteve
4. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve
5. Mirëmbajtjen e varrezave, lapidareve, pllakave përkujtimore, etj..

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Rahovecit janë këto:

- Parqe dhe gjelbërime, 6944 m<sup>2</sup>, këtu çdo vit kemi rritje të sipërfaqeve publike,
- Sheshe, 865m<sup>2</sup>
- Shëtitore pranë lumit, 3160 m<sup>2</sup>
- HHP-të pranë lapidareve, 44 m<sup>2</sup>
- HHP-të pranë pllakave përkujtimore, 4552 m<sup>2</sup>
- Varreza të dëshmoreve, 7528 m<sup>2</sup>
- Varreza të maritëve, 4730m<sup>2</sup>
- Varreza në zonën urbane, 99921.5 m<sup>2</sup>
- Varreza në zonën rurale, 147997 m<sup>2</sup>

#### KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike  
Adresa: B.Cësnariçë e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë  
Tel: +383 29 276 943  
<http://it.rrks.gov.net/rahovec>

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat, duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikisht risi është edhe larja dhe lyerja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës së Rahovecit.

Ne si Drejtori kemi kontraktuar dy operator ekonomik që kujdesen për mirëmbajtjen e hapësirave publike. Ky projekt i ndahet në 2 Lot në DSHP dhe 1 Lot në kuadër të drejtorisë së ekonomisë;

- Lot 1- 65,690.77 euro,
- Lot 2- 22,770.34 euro,
- Lot 3- 19,990.50 euro, ky projekt është në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi dhe specifike e këtij viti është se hapësirat publike llogariten edhe shtigjet e ecjes dhe investimet tjera në kuadër të kësaj drejtorie.

Vlera e tyre në total për tre operator ekonomik sillet në 108,361.61 euro.

Për më shumë detaje dhe sqarime tjera, do të jemi të hapur të diskutojmë gjatë mbledhjes së KPF-së dhe Mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtorja e Shërbimeve Publike

KOMUNA RAHOVEC

---

Drejtorja për Shërbime Publike  
Adresa: R. Dëshmorët e Pashtitkut – p.n. Rahovec, Kosovë  
Tel: +383 23 276 943  
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>